




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. DPKI	Nr. Prot. 06-02/1485/1
Dep. Dep.	Prot. No.
Nr. ifaq. 04	Deza. 16-07-2019
Broj. shënime	Datum. Date
Nr. shtyp.	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 22 (paragrafi 4, 8 dhe 12) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 12.07.2019 mori:

V E N D I M

I. Ekziston konflikti i interesit në rastin nr. AKK-03-02-501/19, për z. Hajriz Koca, Sekretar në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, për shkak se deri para se të zgjidhej dhe emërohej në këtë pozitë i njëjti ishte Këshilltar politik i Ministrisë të po kësaj Ministrie. Kjo situatë bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Agjencia do të kërkoj nga institucioni ku zyrtari i lartë ushtron funksionin që të filloj procedurën për shkarkimin e tij.

III. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit bëhen publike në ueb faqen zyrtare të Agjencisë.

A r s y e t i m

I. Agjencia kundër Korrupsionit, në pajtim të nenit 22 (paragrafi 7) të Ligjit Nr. 06/L-011 për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, ka ndërmarrë të gjitha veprimet procedurale me çka është konstatuar se;

Përzgjedhja dhe emërimi i z.Koca në pozitën Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë është bërë në kundërshtim me Ligjin për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Agjencia kundër Korrupsionit ka trajtuar dhe analizuar rastin e zgjedhjes dhe emërimit të z.Koca në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj Ministrie. Për këtë zyrtarisht ka qenë i njoftuar edhe z.Koca (Dpk-03-02/740/19) dhe po ashtu zyrtarisht i ftuar edhe në takimet e ashtuquajtura “ballafaqimi i fakteve” brenda Agjencisë.

Dyshimi se përzgjedhja dhe emërimi i tij është bërë në kundërshtim me disa dispozita të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, tashmë është konstatim i Agjencisë.

Disa nga dispozitat e nenit 18 të këtij ligji, të cilat kanë të bëjnë me kufizimet pas largimit nga funksioni publik, vlejné edhe për rastin konkret, sepse deri para se të zgjidhej në pozitën e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Inovacionit dhe ndërrmarrësisë, z.Koca ka qenë në pozitën e Këshilltarit politik të Ministrit të po kësaj Ministrie.

Prandaj, për të argumentuar ndalesat ose kufizimet që ekzistojné me Ligjin për Parandalimin e konflikt të interesit në ushtrimin e funksionit publik, po i citojmë disa nga paragrafët e tij, dhe ate si vijon:

Neni 18, Kufizimet e zyrtarit të lartë pas përfundimit të ushtrimit të detyrës publike.

1. Zyrtari i lartë nuk ka të drejtë:

1.1. të punësohet ose të emërohet, për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik, në pozitë udhëheqëse ose menaxhuese, apo të përfshihet në kontrollin ose auditimin e institucioneve publike dhe private dhe institucioneve vartëse të tyre të cilat kanë marrëdhënie biznesi me institucionin ku ka ushtruar funksionin publik, nëse detyrat e tij gjatë periudhës dy-vjeçare para përfundimit të ushtrimit të funksionit publik kanë qenë drejtpërdrejtë të lidhura me mbikëqyrjen, kontrollin apo sanksionimin e aktivitetit të tyre;

1.4. të përdorë informacionin e privilegjuar ose konfidencial të siguruar gjatë ushtrimit të funksionit publik për qëllime e punësimi të tjera në të ardhmen për interesin privat të vet ose të një personi të afërm apo të besuar për një periudhë deri në dy (2) vjet pas përfundimit të funksionit publik.

Punësimi i zyrtarëve të lartë publik në pozita vartëse, ose më të ulëta në institucionet në të cilat ata kanë punuar, është identifikuar si dukuri ekzistuese në vendin tonë dhe po përbënë rrisht të shndërrimit në fenomen në të ardhmen.

Sipas Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, të gjitha institucionet në administratën shtetërore, duke u nisur nga qëllimi

i ligjit, mbi bazën e parimeve të përgjithshme, si ai i profesionalizmit dhe neutralitetit politik, janë përgjegjëse të krijojnë një praktikë të drejtë të organizimit dhe funksionimit, që do të ndikonte në përgjegjshmërinë dhe performancën e institucioneve shtetërore, në interes publik dhe të qytetarëve me profesionalizëm dhe neutralitet politik në vendimmarrje.

Prandaj, me qëllim të parandalimit të kësaj dukurie, Agjencia kundër Korrupsionit, në muajin prill të këtij viti, i ka bërë Rekomandim publik Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (z.d.-01-761/19) që të parandalohet një dukuri e tillë e identifikuar me theks të veçantë në Ndërmarrjet publike, kur zyrtarët e lartë publik shfrytëzojnë autoritetin dhe funksionin e tyre, me qëllim të përfitimit për interesa personale ose për persona të tyre të afërm, që po shfaqen kryesisht në procese të punësimit. Por, siç po shihet edhe nga rastet konkrete, nga kjo dukuri nuk janë kursyer as institucionet tjera publike të vendit.

Për më tepër, qëllimi i Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit është forcimi i integritetit të sektorit publik dhe garantimi i kryerjes së detyrave publike në mënyrë objektive, të paanshme dhe transparente në shërbim të interesit publik nëpërmjet identifikimit, parandalimit, menaxhimit dhe zgjidhjes së konfliktit të interesave të zyrtarëve.

Po ashtu, ekzistojnë disa parime të veprimet dhe mosveprimit të zyrtarit të cilat me Ligj për Parandalimin e konfliktit të interesit janë të dhëna saktësisht në nenin 5, në disa paragraf, si në vijim:

2.Zyrtari duhet ta kryejë punën e tij me ndershmëri, ndërgjegje, paanshmëri, të ruajë autoritetin e zyrtarit dhe institucionit dhe me punën e tij të forcojë besimin e qytetarëve në institucione.

3.Zyrtari, gjatë ushtrimit të funksionit publik, duhet të veprojë në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejtë që interesin e tij privat ta vë para interesit publik.

5.Zyrtari përgjigjet personalisht për veprimet e tij gjatë ushtrimit të funksionit në të cilin është emëruar apo zgjedhur nga institucioni apo qytetarët.

6.Zyrtarit nuk i lejohet të kryejë një veprim të kundërligjshëm apo të mos kryejë një veprim të ligjshëm, gjatë ushtrimit të funksionit të tij, me qëllim të marrjes së një përfitimi të padrejtë për vete ose një person apo subjekt tjetër.

8.Zyrtari duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, i mundshëm apo në dukje.

Ngjashëm janë edhe dispozitat në nenin 9 të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, të quajtura “**Veprime të ndaluara për zyrtarin**” të cilat flasin për veprimet e ndaluara për zyrtarin gjatë ushtrimit të funksionit publik. Ndër të cilat po veçojmë:

1.6 Të shfrytëzoj informatat e besueshme që i ka në dispozicion apo të marra në mirëbesim në ushtrimin e funksionit për përfitime të padrejta për vete apo të çdo personi tjetër fizik dhe juridik, të bashkë aksionareve apo personave në lidhje të mëhershme afariste në pesë (5) vitet e fundit,

1.8 të ndërmarrë veprime të cilat në ndonjë mënyrë do t'i përshtaten apo do të favorizonin interesin privat të ndonjë personi tjetër në dem të interesit publik.

Duhet theksuar se një nga detyrat dhe kompetencat e Agjencisë kundër Korrupsionit është përgatitja dhe përmirësimi i politikave dhe mekanizmave për parandalimin e konfliktit të interesit. Një nga qasjet aktuale dhe në të ardhmen e Agjencisë kundër Korrupsionit është pikërisht parandalimi i nepotizmit në punësime përmes situatave të konfliktit të interesit, si dhe parandalimi i tendencës që zyrtarët e lartë publik të shfrytëzojnë autoritetin dhe funksionin e tyre, me qëllim të përfitimit për interesa personale ose për persona të tyre të afërm, në procese të punësimit si për vete ashtu edhe për të afërmit e tyre.

II. Duke pasur parasysh atë çka u tha me lartë, dhe faktin se zyrtari i lartë z.Koca, pavarësisht nga paralajmërimi i Agjencisë (shkresa zyrtare e dt.20.06.2019) vazhdon të kryej funksionin e tij të papajtueshëm me Ligjin për Parandalimin e konfliktit të interesit, Agjencia kundër Korrupsionit kërkon nga institucioni punëdhënës që të filloj procedurën për shkarkimin e tij. Ndërsa institucioni ku zyrtari vazhdon të kryej aktivitetin ose funksionin e papajtueshëm me këtë ligj, duhet të filloj procedurën për shkarkimin nga funksioni sipas kërkesës së Agjencisë (Neni 22, paragrafi 8).

III. Të gjitha vendimet që i nxjerr Agjencia lidhur me konfliktin e interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe shkellen e dispozitave të këtij ligji, përfshirë veprimet e ndaluara ose të kufizuara në ushtrimin e funksionit publik, ushtrimin e veprimtarive të tjera, papajtueshmëritë në ushtrimin e funksionit publik, duhet të respektohen nga zyrtarët dhe institucionet përgjegjëse. Ato bëhen publike në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë (neni 22, paragrafi 12 i Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit).

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI-së
- Zyrës së Kryeministrit
- Sekretarit të Përgjithshëm të MAP-it
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Shaip Havolli
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

